



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 160, datë 31.10.2025**

**PËR**

**MIRATIMIN E NDYSHIMIT TË STATUTIT SI PASOJË E NDYSHIMIT TË EMRIT TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT NGA “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SH.A. NË “SIGAL INSURANCE GROUP” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr.9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neneve 12, 57 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e ndryshimit të nenit 2, të statutit, si pasojë e ndryshimit të emrit të shoqërisë së sigurimit nga “Sigal Uniqa Group Austria” sh.a., në “SIGAL Insurance Group” sh.a. me këtë përmbajtje:

“Neni 2

**Emërtimi**

Emërtimi i plotë i Shoqërisë është: Shoqëria e sigurimit dhe risigurimit “SIGAL Insurance Group” sh.a. dhe emërtimi i shkurtuar dhe tregtar i saj do të jetë “SIGAL Insurance Group” sh.a. (“Shoqëria”).

Shoqëria ka stemën dhe vulën e saj zyrtare.

Në të gjitha aktet e dala nga Shoqëria të destinuara për të tretët do të tregohet emërtimi i Shoqërisë si dhe adresa e selisë së saj.”

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Saimir TOLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Mimoza KAÇI**